

**Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare - Konferencë Kombëtare**  
**“SFIDAT E ZHVILLIMIT TË TREGJEVE NËN MBIKËQYRJEN**  
**E AMF-SË DHE EDUKIMI FINANCIAR”**  
**24 Maj 2018 - Tiranë, Shqipëri**

**TREGU I OBLIGACIONEVE TË BASHKIVE SI ALTERNATIVË PËR FINANÇIMIN E**  
**ZHVILLIMIT URBAN**

**Anisa Plepi<sup>1</sup>**  
**Andi Plepi<sup>2</sup>**

*Abstrakt*

Që prej rënies së regjimit komunist në Shqipëri në 1991 dhe fillimit të procesit të tranzicionit nga një ekonomi e centralizuar në ekonomi tregu, popullsia urbane është thujse dyfishuar. Kështu, në 1991 vetëm 36.7% e popullsisë jetonte në zona urbane, ndërkohë deri në 2017 kjo shifër shkon në 59.38%, vlera më e lartë e regjistruar në 56 vitet e fundit. Në këtë aspekt, tranzicioni demografik nga rural në urban, parashtron nevojën që “liderat e qyteteve” t’u përgjigjen sfidave të një popullsie urbane në rritje në sigurimin e shërbimeve bazike, infrastrukturës dhe strehimit të përballueshëm.

Për më tepër, me reformën e re territoriale, decentralizimi fiskal ka transferuar një pjesë të mirë të përgjegjësisë për investime në infrastrukturë te qeveritë lokale, buxhetet e të cilave mbeten të limituara përballë nevojave në rritje për investime. Në këtë kontekst, zhvillimi urban parashtron nevojën për forma alternative financimi që kanë potencialin të plotësojnë hendekët aktualë në financim. Ky artikull, ndalet në eksplorimin e tregjeve të obligacioneve bashkiake si një alternativë për financimin e zhvillimit të qyteteve dhe infrastrukturës së tyre, duke u fokusuar në dy pyetje kryesore:

1. A është gati Shqipëria për prezantimin e obligacioneve bashkiake si alternativë për financimin e infrastrukturës urbane, kjo parë në këndvështrimin e emetuesve?
2. Cila do të ishte strategjia më e përshtatshme për implementimin e tregut të obligacioneve bashkiake?

***Fjalët kyçe:** obligacione bashkiake, zhvillim urban, decentralizim fiskal, financat lokale.*

---

<sup>1</sup> Pedagogë, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë, anisaplepi@feut.edu.al

<sup>2</sup> Student Master Shkencor, Universiteti i Tiranës, andiplepi23@gmail.com